

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"VELLEZERIT AHMETI" SHPK

Sot, më datë 02/11/2022, u paraqit personalisht:

- **Z. Naser Ahmeti**, e datëlindjes 16/06/1963, shtetas kosovar, lindur ne Dvorishte dhe banues ne Kosovë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i leternjoftimit me Nr. 251539 dhe Nr. Personal ID0813178.

i cili përpiloi këtë akt themelimi të shoqërisë tregtare "**VELLEZERIT AHMETI**" SH.P.K, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Forma Ligjore

Të themeloj Shoqërinë Tregtare "**VELLEZERIT AHMETI**" SH.P.K, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri "**VELLEZERIT AHMETI**" SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme tregtare. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë tërësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3

Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit "**VELLEZERIT AHMETI**" SH.P.K dhe me emrin tregtar **VELLEZERIT AHMETI**. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

- Tregëtim fidanë

NENI 5

Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në Velipojë, në adresën: **Arë ne lagjen Prekaj, Prekaj, Nr. Pas 864/36, Z.K. 3734, Velipojë.**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.



NENI 6

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar është Lekë 300.000 (treqind mije leke) dhe zotërohet nga ortakët themelues:

Vlera totale e kapitalit të regjistruar: Lekë 300.000 (treqind mije leke)

Vlera e paguar: 300.000 leke

Numri total i kuotave: 1.

NENI 7

Ortakët themelues të Shoqërisë Tregtare " **VELLEZERIT AHMETI** " SH.P.K zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Ortakët themelues :	Naser Ahmeti
Numri i kuotave :	1
Numri i pjeseve :	1
Pjesëmarrja në Shoqëri :	100,00 %
Lloji i kontributit:	Ne para
Vlera e kontributit	300,000 (treqind mije) leke

Duke qenë se Kapitali themeltar do të depozitohet në llogarinë e Shoqërisë e cila do të hapet pas regjistrimit në QKB, atëherë ortakët vendos që kjo shume do të paguhet prej tij jo më vonë 3 muaj nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB, në llogarinë e shoqërisë tregtare. Rregullat e pagesës së kësaj shume janë parashikuar në këtë Statut.

NENI 8

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 9

Administratori/ët

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit/ëve të cilët zgjidhen për një mandat 5 (pese) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i shoqërisë do të jetë :

- **Z. Naser Ahmeti**, e datëlindjes 16/06/1963, shtetas kosovar, lindur në Dvorishte dhe banues në Kosovë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i leternjoftimit me Nr. 251539 dhe Nr. Personal ID0813178.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administrator/ët, duke i ushtruar këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Oratku/ Ortakët mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Ortaku/Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

NENI 12

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 13

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku Themelues, u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimit hartohet në gjuhën shqipe, duke qene se ortaku eshte njohes te gjuhes shqipe.

ORTAKU THEMELUES

Naser Ahmeti

